

Në Prishtinë, më 5 tetor 2015

I/E nderuar

Me 25 dhe 26 shtator, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në mjediset e saj u mbajt Konferenca shkencore “Studimet Albanistike në Amerikë”, në të cilën ishin ftuar 48 pjesëmarrës nga Kosova, Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania, Italia, Polonia, etj. Për dy ditë me radhë në tetë seanca u paraqitën kumtesa shkencore me shumë interes për gjuhën, letërsinë, kulturën shqiptare në përgjithësi, me rezultate që sollën njohuri të reja për këto studime në kontinentin Amerikan.

Konferencën e hapi akademik Rexhep Ismajli, ndërsa e përmbylli ballkanologu dhe albanologu i njohur nga Universiteti i Çikagos prof. Victor Friedman, me vlerësimin se “Programi i pasur dhe kumtesat që kemi dëgjuar kanë qenë në një nivel shumë të lartë, me shumë informata dhe analiza të reja... Studimet albanologjike në Amerikë me të vërtetë meritojnë vëmendjen që u kemi kushtuar, edhe për arritjet në të shkuarën, edhe për hulumtimet që bëhen tani, edhe për hulumtimet në të ardhmen...”

Konferenca shënoi dhe 95 vjetorin e lindjes së albanologut të shquar Eric Pratt Hamp, profesor emeritus i Universitetit të Çikagos, anëtar i jashtëm i AShAK-ut, studiues me autoritet botëror në gjuhësinë bashkëkohore, i cili për shkak të moshës nuk mund të udhëtonte në Prishtinë. Me këtë rast Presidentja e Kosovës, zonja Atifete Jahjaga e dekoroi profesor Hampin me Medaljen Presidenciale të Meritave, për kontribut të jashtëzakonshëm në studimin dhe afirmimin e gjuhës shqipe.

Pjesëmarrësit e Konferencës Shkencore “Studimet albanistike në Amerikë – Albanian Studies in America” në fund miratuan **THIRRJEN E KONFERENCËS**, që u drejtohet opinionit publik e shkencor, autoriteteve shkencore dhe universitare të Kosovës e të Shqipërisë, autoriteteve universitare e shkencore të ShBA-së, komunitetit shqiptar në ShBA dhe gjithë faktorëve të rëndësishëm në relacionet midis botës shqiptare dhe botës amerikane, që me përparësi të shtojnë çështjen e themelimit të një qendre hulumtuese arsimore të nivelit universitar në një prej qendrave universitare amerikane dhe me kritere të atjeshme.

Duke qenë thellësisht të bindur se një thirrje e tillë, të cilën po jua bashkëngjesim me këtë letër, duhet të mbështetet dhe të gjejë rrugët e sendërtimit sa më të shpejtë, duke shpresuar në ndihmën tuaj të pakursyer, ju drejtohem edhe ne me thirrjen që ta përkrahni dhe ta shtyjmë drejt realizimit sa më të shpejtë këtë dëshirë të kahmotshme të studiuesve shqiptarë dhe amerikanë.

Prishtinë, 1 tetor 2015

Me nderime,

Akadmik Hivzi Islami,

Kryetar i AShAK